



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО - UNIVERSITY OF TETOVA


Bul. "Ilinden" p.n. 1200 Tetovë | Tel: +389 44 356 500 | Fax: +389 44 356 222
e-mail: international@unite.edu.mk | www.unite.edu.mk

NJOFTIM

Njoftohen të interesuarit se Buletini nr. 152 i Universitetit të Tetovës është publik dhe i njëjti mund të shikohet nga të interesuarit te Dekanët e fakulteteve të Universitetit të Tetovës.

Buletini do të jetë publik duke filluar nga 12.11.2019 deri më 26.11.2019.

Tetovë, 12.11.2019

Zyra për çështje juridike





UNIVERSITETI I TETOVËS

UNIVERSITY OF TETOVA - УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО

UT Rectorate - Ilinden nn, 1200 Tetovo, Macedonia

Tel: +389 44 356 500; Fax: +389 44 334 222, email: international@unite.edu.mk

PASQYRË

e titujve të temave për punime të doktoraturës të pranuar nga Këshilli Mësimor-Shkencor i Fakultetit

Titulli i temës	Vendimi për pranimin e temës	Mentori	Vendimi për caktimin e mentorit	Kandidati
Fakulteti Ekonomik Shkenca Ekonomike Drejtimi: Financa				
“Roli i mikrofinancimit dhe zhvillimit të NMV-ve në uljen e varfërisë në Maqedoni”	14-1076/1 30.09.2019	Prof. Dr. Seadin Xhaferi	14-1076/2 30.09.2019	Vjollca Hasani Limani
Drejtimi: Ekonomi e aplikuar				
“Menaxhimi i shërbimeve shëndetsore në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës dhe faktorët që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve”	14-740/2 29.09.2019	Prof. Dr. Naser Raimi	14-740/3 29.09.2019	Haqif Arifi
Drejtimi: Marketing				
“Roli ekonomik i NVM-ve nëpër komunat si parakusht për zhvillimin e përsheptuar socio-ekonomik të Republikës së Kosovës”	14-1077/1 30.09.2019	Prof. Dr. Naser Raimi	14-1077/2 30.09.2019	Shpresa Bajrami
Fakulteti Juridik Historia e institucioneve dhe shteti i së drejtës Drejtimi: Historia e shtetit				
“Të drejtat e të pandehurit në procedurën penale – Rasti i Kosovës”	13-477/6 29.10.2018	Prof. Dr. Fatmire Lumani	13-477/7 29.10.2018	Adelina Rakaj

“Shkaqet, format e manifestimit dhe parandalimi i kriminalitetit të fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut”	13-756/4 05.09.2019	Prof. Dr. Afrim Osmani	13-756/5 05.09.2019	Nazmije Shaqiri
Drejtimi: Marrëdhënie ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë				
“Roli i Shqipërisë në bashkëpunimin ndërkombëtar në luftimin e krimit të organizuar”	13-758/4 05.09.2019	Prof. Dr. Afrim Osmani	13-758/5 05.09.2019	Anton Bardhaj
Fakulteti i Kulturës Fizike Kineziologji				
“Dallimet në treguesit kinematik ndërmjet gjuajtjeve më kërcim dhe pa kërcim nga pozita të ndryshme në lojën e basketbollit”	19-239/6 27.06.2018	Prof. Dr. Fadil Rexhepi	19-239/7 27.06.2018	Diellza Kelmendi
“Zhvillimi i disa aftësive kondicionale te atletët dhe karatistët e rinj të moshave 10-12 vjeç gjate procesit stërvitor një vjeçar”	19-141/1 15.03.2019	Prof. Dr. Visar Ganiu	19-141/2 15.03.2019	Alim Hajredini
“Analiza e pozicioneve të lojtarëve në basketboll në bazë të karakteristikave morfologjike dhe testeve aerobo-anaerobe”	19-121/2 27.03.2019	Prof. Dr. Isa Asllani	19-121/3 27.03.2019	Artan Kryeziu
“Ndikimi i forcës eksplozive në efikasitetin e rezultateve në shtytjen e gjyles”	19-445/3 17.10.2019	Prof. Dr. Isa Asllani	19-445/4 17.10.2019	Agron Thaqi
“Krahasimet e basketbollistëve junior të supër ligës dhe ligës unike të Kosovës në parametrat antropometrike dhe në aftësitë motorike e funksionale”	19-448/2 17.10.2019	Prof. Dr. Metin Dalip	19-448/3 17.10.2019	Bujar Begu

Universiteti i Tetovës

Fakulteti Filozofik

Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Filozofik të Universitetit të Tetovës në mbledhjen, e vet të mbajtur më 19. 09. 2019 mori vendim për formimin e komisionit për vlerësimin shkencorë e profesional të dorëshkrimit të temës së Doktoraturës me titull; PREFEKTURA " KOSOVA" – KRUMA DHE KONTRIBUTI I SAJ PËR KOSOVËN 1922 -1939 të kandidatit Zog Çoçaj.

Komision i përbërë nga: **1. Prof. dr. Vebi Xhemaili, kryetar, 2. Prof. dr. Nebi Dervishi anëtar, 3. Prof.dr. Zeqirja Rexhepi anëtar, Prof.dr. Isak Sherifi, Anëtar, Prof.dr. Zeqirja Idrizi Mentor.** Pasi komisioni lexoi materialin që kishte në disponim Këshillit Mësimor-Shkencor të fakultetit Filozofik i paraqet këtë:

Referat

Mr. Zog Çoçaj është lindur 20-08-1983 në fshatin Gjonaj Komuna e Prizrenit. Shkollën fillore e mbaroi në vendlindje në vitin 1997, kurse shkollën e mesme në e mbaroi në vitin 2001 edhe Fakultetin Filozofik Degën e historisë në vitin 2001=2005 në prishtinë. Studimet pasuniversitare i kreu në Universitetin e Prishtinës 2012=2014, si dhe studime pasuniversitare në Kolegjin Dardania gjat vitit 2006-2008, gjithashtu ka kryer edhe nivelin Bachelor Gjuhe dhe letersi shqipe në Universitetin e Prishtinës dega në Prizren në vitin 2010=2014. Zog Zog Çoçaj gjat vitit 2008=2009 ka punuar në Kuvendin Komunal në Prizren. Megjithatë ai aktualisht punon në shkollën fillore "Zenun Çoçaj" Gjonaj.

Prej shumë vitesh merret me publicistikë, nga lëmi i kulturës dhe shkencës historiografike dhe deri tani ka botuar shumë artikuj, studime në shtypin ditor, javor, mujor dhe në revistat shkencore. Ka marrë pjesë në tubime e simpoziume shkencore në Kosovë dhe jashtë me trajtesa të ndryshme dhe vendbanimeve në Kosovë.

Temat që trajton kandidati Mr.Zog Cocaj kanë të bëjnë me të kaluarën e hidhur nëpër të cilat kaloi populli shqiptar të cilat me atë rast ai i arsyeton dhe argumenton qëllimet e trajtimit të temave duke theksuar vështirësitë ekonomike, politike, shoqërore, dhe kulturore në Shqipëri e Jugosllavinë e para Luftës së Dytë Botërore e që janë temë bosht i trajtesave të tij. Kandidati gjithashtu bën të ditur për metodat akademike të përdorura në hartimin e studimeve si dhe për literaturën dhe bibliografinë e përdorur gjatë hartimit të tyre. Në veçanti kandidati bën një qasje kritike dhe të argumentuar, gjithnjë mbi bazën e fakteve arkivore të momentit kur janë zhvilluar ngjarjet dhe veprimtarinë e sakrificën e atyre që dhanë jetën për të mirën e popullit shqiptar dhe në mbrojtje të atdheut në syt e diplomacisë evropiane. Segmente të veçanta të cilat i trajton kandidati janë, ato që kanë të bëjnë me Prefekturën e Kosovës me seli në Krumë dhe aktivitetin e veprimtarëve, martirëve, dëshmorëve, dhe heronjve të popullit . Në këtë pikë kandidati bën përpjekje të argumentuara që të jep vlerësime mbi shkaqet që e sollën në një gjendje tepër të rëndë politike popullin shqiptar të Kosovës përballë mizorive serbe dhe me mjaft shembuj dhe detaje studimore trajton thellimin e veprimtarisë së shumë personaliteteve të kohës kur vepruan. Segment të veçantë të trajtimit këtu zë edhe qëndrimi kombëtar i shumë veprimtarëve të cilët kritikonin haptas udhëheqjen e pushtetit të përberë vetëm nga serbët që kishin sjellje shumë të këqija ndaj shqiptarëve – kosovarëve të cilët kërkonin ndarjen e pushtetit në mes të shqiptarëve dhe serbëve, edhe pse 99% e popullsisë ishte shqiptare...

Në vazhdim kandidati, gjithnjë përmes analizimit të burimeve shtjellon, mënyrat, metodat, strategjinë, e qeverisjes antishqiptare nga pushtetarët serb duke u ndalur në çështjet e spastrimit etnik të shqiptarëve, burgosjen e veprimtarëve shqiptarë të cilët merrnin guxim për të kundërshtuar padrejtësinë e pushtetit serb. Gjithashtu kandidati Zog Çoçaj flet edhe për shpalljen e Mbretërisë Shqiptare dhe qëndrimi i saj ndaj problemeve të Kosovës”, trajton ndryshimin e sistemit shtetëror, i cili sistem nuk u prit mirë nga atdhetarët, ndërsa në anën tjetër Mbreti i shqiptarëve Ahmet Zogu për të fituar vëmendjen e të gjithë shqiptarëve ndryshoi dukshëm qëndrimin ndaj të shpërngulurve filoj të interesohej edhe më shumë, duke nxjerr disa ligje dhe duke u siguruar shqiptarëve jo vetëm

vend për t'u strehuar, por edhe toka pune për ta mbajtur familjen si dhe bëri përpjekje t'u siguronte edhe punë.

Kandidati me një qëndrim objektiv të paanshëm hulumtues trajton zhvillimet tejet dramatike në atë periudhë tepër dramatike për shqiptarët në ish Jugosllavi si një ndër vitet më të vështira nëpër të cilat po kalonte populli shqiptar në njërin anë e në anën tjetër aktivitetet e veprimtarëve që ishin në vllugun më të madh deri në luftën e fundit shqiptaro-serbe, që kurorëzohet me çlirimin e Kosovës. Në fushë të dijes historiografike Zog Çoçaj me emër të tij, deri tani ka publikuar artikuj, trajtesa, e kritika të ndryshme, fejtone, e studime historiografike. Përpos atyre Zog Çoçaj botoi edhe keto vepra historiografike;

Në dorëshkrim: "Burgu i Stara Gradishes dhe shqiptarët " „Percaktimi i zones kufitare” .

Konferenca e I-rë doktrale në UT, më 2015/2016 – skeleti i temës

Konferenca e II-të doktrale në UT, më 2016/2017 –zgjedhja e temës

Konferenca e III-të doktrale në UT, më 2018/2019 –prezantimi i punimeve në revistat shkencore

1. Seminari XII Ndërkombëtar të Albanologjisë Skënderbeu mes historisë dhe letërsisë Unversiteti i Tetovës, 28 shtator 2018 me temën: “Hasi vend origjina e Skënderbeut”

2. Konferencë shkencore organizuar nga Klubi “Shtjefën Gjeçovi “ në Mazrrek më datën .14.01.2019 me temën; “Familja e Skënderbeut ishte nga Hasi, që më vonë e shtrinë principatën e tyre në Dibër , Mat dhe Mirditë”

3. Instituti për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim në Ulqin , më 04.05.2019 ku prezentova me temën: “Arsimi në territorin e Prefekturës së Kosovës “

2. Konferencë shkencore organizuar nga Klubi “Shtjefën Gjeçovi “ në Mazrrek më datën .14.01.2019 me temën; “Familja e Skënderbeut ishte nga Hasi, që më vonë e shtrinë principatën e tyre në Dibër , Mat dhe Mirditë”

3. Instituti për Kërkime Shkencore dhe Zhvillim në Ulqin , më 04.05.2019 ku prezentova me temën: “Arsimi në territorin e Prefekturës së Kosovës

Seminari XIII Ndërkombëtar të Albanologjis 25-26 shtator 2019. Tetovë:Tema Çështja kufitare ne vitin 1913.

Publikimet në revista :

1. Vizion Nr. 30 2018, ISSN 1409-8962/ ISSN 1857-9221 UDC 316,33,32, që botohet në Shkup, u publikua punimi me titull: “Prefektura “Kosova “ dhe kontributi i saj për Kosovaret” nga fq. 235 deri në faqen 251

2. Vizion nr. 31, 2018, Shkup, ISSN 1409-8962/ ISSN 1857-9221/UDC 316,33,32, u publikua artikulli im: ” Qëndrimi i Ahmet Zogut ndaj nacionalistëve Kosovarë dhe masat e ndërmarra pas vitit 1925” nga fq.281 deri në fq. 292

Aktivitete shkencore në cilësinë e pjesëmarrësve vëzhgues në konferenca :

Akademia e Shkencave në Tiranë, më datën 10.04.2018 me temën qendore “ Ruajtia e trashëgimis kulturore në Shqipëri dhe Kosovë “

Konferenca Shkëncore e Institut të Historisë në Prishtinë dhe Tiranë, në kuadër të përvjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizreni, Prizren më 10.06.2018.

Recenzentë i vepres “Internati Kosova”1928-2018 të autorëve Shaqir Lushaj dhe Dan Poga,Bogdani, Prizren,2018.

Praktika një mujore nëUniversitetin e Prishtinës Fakulteti Filozofik- Histori nën mentorimin e prof.dr. Ibrahim Gashit.

Tema e doktoranturës e kandidatit Zog Çoçaj hapet me pjesen hyrëse në të cilën kandidati arsyton dhe argumenton qëllimet e trajtimit të temës ne fjalë. Në vështrimin hyrës, përfshihen: Arsyet pse është përcaktuar për këtë temë studimore, sa interesante aq edhe sfiduese, objektivat e temës dhe metodat shkencore, shtegu, literatura, puna në terren. Në këtë pjesë, me pak fjalë është

përpjekur, që të tregoj për gjendjen dhe faktorët të cilët kanë ndikuar në themelimin e Prefekturës së Kosovës, rolin e saj për t'u dalë në ndihmë të shpërngulurve me dhunë nga Kosova. Gjithashtu në këtë pjesë ka dhënë edhe sqarimet e mbështetjes së metodave shkencore, të cilat e kanë ndihmuar në zbërthimin e materialit arkivor, në njërën anë analizën e literaturës së shkruar dhe gërshetimin e të dhënave që i ka mbledhur gjatë hulumtimit për këtë temë. Duhet pranuar faktin se puna në terren dhe kontakti me familjarët e të shpërngulurve nga Kosova, në masë të madhe kanë ndikuar për ta orientuar tezën e doktoratës.

Kandidati në vijim temën e ndan në pesë kapituj te grupëzuar në disa nënkapituj, ndërsa në kapitullin e parë me titull: Pozita gjeografike dhe të dhëna demografike, përmes katër nënndarjeve arrin të sjell një informacion të pasur në lidhje me pozitën gjeografike të qendrës së Prefekturës "Kosova" – Hasit, duke treguar se çfarë mundësie ka afruar kjo qendër gjatë viteve për t'i ndihmuar të shpërngulurit me dhunë nga Kosova. Gjithashtu, karshi të dhënave gjeografike follet në pika të shkurtra edhe për një historik të shkurtër të kësaj zone, që i kishte dhënë aq shumë historisë së popullit shqiptar, sa kanë ndikuar më pas këto fakte historike që të mendohet dhe të vendoset pikërisht në Krumë qendra e Prefekturës së "Kosova". Meqenëse në kuadër të Prefekturës së "Kosova" bënin pjesë edhe nënprefekturat e Lumës dhe të Malësisë së Gjakovës, si dhe veç e veç ka dhënë disa të dhëna, që flasin për territorin dhe shtrirjen e këtyre nënprefekturave, që gjithashtu e përshkojnë vijën kufitare, që ndau trojet shqiptare nga Shqipëria politike. Për qendrën e Prefekturës Kosova, Hasin, e ka parë të udhës që të flas shkurtimisht në një nënndarje të veçantë edhe për prejardhjen e emrit Has, gjithnjë mbështetur në të arriturat shkencore të deritashme, me qëllim që të krijohet një pasqyrë më e mirë për qendrën e prefekturës në vitet e themelimit.

Në këtë kapitull mbështetur në të dhënat arkivore dhe në literaturën e botuar, flet për problemin e Kosovës, i cili problem nuk ka nisur të njihet vetëm pas ndarjes së saj nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër, por e ka gjenezën shumë shekuj më parë, përkatësisht nga Lufta e Kosovës e këndej, por gjithsesi problemi i Kosovës u bë më i theksuar pas vitit 1912, kur Kosova dhe trojet tjera shqiptare mbetën jashtë Shqipërisë Politike (Londineze 1913). Në nënndarjen Çështja e Kosovës në Konferencën e Paqes 1919-1921, kandidati flet me gjuhën e argumenteve për shqyrtimin e problemit të viseve të pushtuara nga Serbia. Pavarësisht kësaj as Konferenca e Paqes nuk e zgjidhi çështjen e Kosovës dhe të shqiptarëve, por e la nën Serbi, përkatësisht nën Mbretërinë Serbo - Kroato - Sllovene. Në një nënndarje të veçantë kandidati, Zog Çoçaj flet për

ripushtimin e zonave kufitare nga serbët dhe pasojat e këtij pushtimi 1918 -1921, i cili ripushtim e ngadalësoi në masë të madhe ecjen e shtetndërtimit të Shqipërisë e me këtë la anash edhe çështjen e Kosovës dhe fatin e shqiptarëve që mbetën nën sundimin sllav.

Për të pasur një pasqyrë më të plotë të rrethanave, që çuan në krijimin e Prefekturës së Kosovës, në zonat kufitare me Kosovën, në një nënndarje me titull "Situata politike dhe ekonomike në Kosovë dhe organizimet e lëvizjeve kaçake falë ndihmës së banorëve të zonave kufitare" gjithnjë duke e prek situatën politike dhe zhvillimin e dobët ekonomik, që ndikuan shumë në mundësitë e kufizuara të kësaj prefekturë për të qenë në shërbim të plotë të të dëbuarve me dhunë nga trojet e tyre. Mungesa e tokës së punës, apo sigurimi i bukës, ishin probleme me të cilat u ballafaquan banorët e kësaj prefekturë, meqë vënia e kufirit provizor ndërpreu në masë të madhe lidhjet tregtare të kësaj zone me tregjet e Kosovës e në veçanti me Prizrenin dhe Gjakovën. Në pjesën e fundit të kapitullit të parë, bëhet fjalë për Komitetin "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" dhe kontributi i saj për Kosovën.

Në kapitullin e dytë me titull: Themelimi i Prefekturës së Kosovës më 1922, të cilin kapitull e ka ndarë në shtatë nënkapituj, ku bëhet fjalë për rrugën që ndoqën atdhetarët kosovarë për themelimin e Prefekturës "Kosova" dhe jehona e saj tek të gjithë të shpërngulurit. Në të vërtetë themelimi i Prefekturës së "Kosova" u dha zemër dhe krah atdhetarëve, që ta vazhdojnë luftën për çlirim deri në bashkimin e trojeve shqiptare, që padrejtësisht mbetën jashtë Shqipërisë.

Prefektura "Kosova", e cila sipas dokumenteve u themelua më 30 dhjetor 1921, në të cilën datë me propozim të Hoxhë Kadri Prishtinës prefekt i parë i kësaj prefekturë u emërua Bedri Pejani, njëri ndër aktivistët më të zëshëm të KMKK, të cilit më pas iu bashkëngjiti edhe Tahir Zajmi në detyrën e sekretarit të dytë të kësaj prefekturë. Gjithashtu kandidati veçon fillimin e punës së kësaj prefekturë, e cila u mirëprit nga të gjithë kosovarët në veçanti, por edhe nga banorët e zonave të Lumës dhe të Malësisë së Gjakovës, të cilët në pikëpamjen e atdhedashurisë ishin të një mendje. Në vazhdim të këtij kapitulli, Zog Çoçaj bënë fjalë edhe për rrethanat ekonomike dhe politike, që çuan në themelimin e Prefekturës së Kosovës, si dhe për shtypin e kohës për ngjarjet në Kosovë gjatë viteve 1922 – 1924, që ishte mënyrë më e mirë e komunikimit të atdhetarëve me Kosovën, në fakt për t'u informuar për të gjitha masakrat dhe dhunën që e ushtronte Serbia ndaj popullit të pambrojtur të Kosovës. Në nënkapitullin me titull "**Kontributi i Prefekturës "Kosova" për shqiptarët e Kosovës**" sjellim fakte dhe argumente. Kontributi i Prefekturës së Kosovës për shqiptarët e Kosovës, që është një ndër nënkapitujt e kapitullit të dytë kandidati e mbulon me

argumente në veçanti kontributin e kaçakëve, përpjekjet e atdhetarëve për organizimin e jetës shoqërore e politike, duke e shndërruar Krumë-n, në një qendër revolucioni kundër regjimit Jugosllav dhe njëherit do të ishte një ndihmesë e madhe për banorët e kësaj ane pikërisht nga kjo prefekturë. Në vazhdim në tre nënkapitujt vijues kandidati ka paraqitur organizimin e administratës për qendrën e Prefekturës, nënprefekturës në Lumë dhe në Malësi të Gjakovës dhe kontributin e tyre për çështjen kombëtare e në veçanti për ndihmën, që jepnin në përgjithësi administrata shtetërore për emigrantët kosovarë si dhe për inkuadrimin e disa prej tyre në punë shtetërore si në xhandarmëri, e në shumë funksione tjera.

Gjithashtu në fund të këtij kreu në mbështetje të dëshmimeve arkivore Zog Çoçaj paraqet përfaqësimin e kosovarëve në institucionet e shtetit shqiptar, përfshi këtu në Parlamentin e Shqipërisë, si dhe qëndrimi i shtetit ndaj kosovarëve. Zëri i kosovarëve u lidh ngushtë edhe me zërin e ndërgjegjes kombëtare e në veçanti me njeriun që e vrau tradhtarin e Kombit Esat Pashën, që deshi të bashkëpunoi me Jugosllavinë në dëm të shqiptarëve. Vepra atdhetare e Avni Rustemit, ndikoi që populli i kësaj prefekturë, të votojë për te dhe me kënaqësi e pranoi kandidaturën e tij në Prefekturën e Kosovës, ku të gjithë të tjerët kandidatë ishin kosovarë.

Në kapitullin e tretë me titull: Prefektura e Kosovës dhe veprimtaria e saj në vitet 1922 – 1924, kandidati përshkruan aktivitetin e madh të veprimtarisë së Prefekturës së Kosovës dhe kontributin i kosovarëve në çdo aspekt.. Me pak fjalë Prefektura e Kosovës që bërë zëdhënëse e popullit të Kosovës dhe me plotë të drejtë mund të themi se Kosova dhe populli i saj nisi të frymojë tash përmes kësaj prefekturë.

Ky kapitull, sikurse edhe të tjerët është ndarë në disa nënkapituj, ku në secilin prej tyre me gjuhën e argumenteve Çoçaj prezanton kontributin e Prefekturës për çështjen shqiptare dhe përfaqësimi i denjë i kosovarëve në të gjitha institucionet. Këtu duhet ai, përmend faktin se në këtë periudhë në qendrën e Prefekturës së Kosovës në Krumë u themelua edhe një shoqëri kulturo arsimore me emrin “Shkelzeni”, përmes së cilës shoqëri u zhvillua aktiviteti i kosovarëve në çdo pikëpamje. Prefektura e Kosovës, aq më shumë kosovarët ndihmuan që të zhvillohet një kryengritje e madhe, e cila nxiti popullin të bëjnë revolucion për të ndryshuar çështjen e sendërtimit, dhe rrëzimin e qeverisë të diktuar nga Ahmet Zogu. Po as Qeveria e Nolit, nuk bëri ndryshime të mëdha, sepse nuk ishte syhapur sa duhet dhe më pas po me ndihmën e shqiptarëve e të përkrahur nga Mbreti i Serbisë u rikthye Ahmet Zogu.

Gjithashtu kandidati Çoçaj thekson se në këtë periudhë kohore Zona kufitare përjetoi lulëzimin më të madh në arsim, kohë kur në Kolgecaj u themelua Internati "Kosova" dhe u hapën disa shkolla, të cilat pos nxënësve kosovarë në këto shkolla punonin numër më i madh i mësuesve nga Kosova e në veçanti nga Gjakova.

Në kreun e katërt me titull: Prefektura e Kosovës 1925 – 1928, në veçanti kandidati ndalet në pjesën e kthimit të Ahmet Zogut përmes ndihmës së Jugosllavisë përsëri në krye të shtetit. Kjo mënyrë e ardhjes së tij në pushtet, nuk ishte shenjë e mirë për kosovarët e në veçanti për ata të cilët ishin përcaktuar që për vendin dhe çlirimin e tij nuk do ta ndajnë kurrë pushkën nga krahët. Me theks të veçant për këtë çështje kam flasim në nënkapitullin me titull : "Qëndrimi i Ahmet Zogut ndaj nacionalistëve kosovarë dhe masat e ndërmarra pas vitit 1925", ku do të shihet qëndrimi antikosovarë dhe ndjekja e tyre, arrestojë, burgos dhe t'i vras të gjithë kundërshtarët e tij politik. Qëndrimi i Ahmet Zogut ndaj veprimtarëve kosovarë ndikoi që më pas të bëhet edhe suprimimi i qendrës së Prefekturës së Kosovës nga Kruma dhe të vendoset në Kukës, sipas kërkesës së lumjanëve, të cilët në fakt kishin ndihmuar shumë në rikthimin e tij në pushtet. Në këtë aspekt duhet të veçohet kontributi i Muharrem Bajraktarit, Alush Agë Luma, por duke mos u lënë anash as kontributi i disa kosovarëve, të cilët ishin në vijën e Ahmet Zogut siç ishte Ceno bej Kryeziu dhëndri i Zogut dhe vëllai i tij Hasan Kryeziu, pastaj Bahri Begolli, që të gjithë njerëz të paguar nga Serbia jo vetëm për ta ndihmuar Zogun, por edhe për ta destabilizuar Shqipërinë edhe më vonë.

Me rikthimin e Ahmet Zogut në Shqipëri kandidati thekson se ndryshoi shumë edhe qëndrimi i Shqipërisë ndaj kosovarëve, shumë herë bëheshin përpjekje që atdhetarët kosovarë të strehuar në Shqipëri të ktheheshin në Jugosllavi dhe të dënoheshin për veprat e bëra, të tjerët që mbetën në Shqipëri nuk u përkrahën dhe u lanë të vuajnë, me pak fjalë nuk u përfshinë më në administratën e Prefekturës si më parë. Në këtë periudhë kohore edhe arsimit i fëmijëve të kosovarëve mbeti mbrapa, sepse nuk ekzistonte më entuziazmi si më parë, për çka do të duhej kohë që të rikthehet interesimi për arsim. Gjithashtu edhe çështja e kufijve pas rikthimit të Ahmet Zogut u riaktualizua, por pa ndonjë rezultat. Përmes disa dëshmimeve të shkruara thuhet se u kërkua që Hasi i mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë politike t'i bashkohej Shqipërisë nëse dëshironte Jugosllavia që të merrte Shën Naumin sipas marrëveshjes së 14 gushtit të vitit 1924, por rezultoi e tërë kjo propagandë të ishte vetëm lojë, që të arsyetohet Ahmet Zogu para popullit se gjoja po

interesohet për vendin e në veçanti për çështjen e Kosovës dhe të viseve tjera që mbetën jashtë Shqipërisë politike.

Në kapitullin e pestë me titull: “Prefektura e Kosovës 1929 – 1939”, e ndarë në shtatë nënndarje Zog Çoçaj me një përkushtim të madh paraqet të gjitha ngjarjet dhe lëvizjet që ndodhën në Prefekturën e Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore. Në anën tjetër flet për zhvillimin ekonomik të Prefekturës së Kosovës gjatë periudhës 1929 -1936, që ishte gjendje shumë e rëndë e shoqëruar me një varfëri të madhe. Por, pavarësisht kësaj varfërie, zemrat dhe dyert e banorëve të këtyre zonave ishin të hapura për shqiptarët e shpërngulur. Rrëfimet e shumë familjarëve të të shpërngulurve tregojnë më së miri për kujtimet e prindërve të tyre, të cilët edhe sot i ruajnë ato kujtime për banorët e Hasit dhe të Malësisë së Tropojës, që u gjetën shumë afër në ditët më të vështira. Nënkapitullin “Shpallja e Mbretërisë Shqiptare dhe qëndrimi i saj ndaj problemeve të Kosovës”, trajtojmë ndryshimin e sistemit shtetëror, i cili sistem nuk u prit mirë nga atdhetarët, ndërsa në anën tjetër Mbreti i shqiptarëve Ahmet Zogu për të fituar vëmendjen e të gjithë shqiptarëve ndryshoi dukshëm qëndrimin ndaj të shpërngulurve dhe nisi të interesohej edhe më shumë, duke nxjerr disa ligje dhe duke u siguruar shqiptarëve jo vetëm vend për t’u strehuar, por edhe toka pune për ta mbajtur familjen si dhe bëri përpjekje t’u siguronte edhe punë. Ndërsa në nënkapitullin “Përfshirja e kosovarëve në institucionet e shtetit dhe në nivel të prefekturës”, janë dhënë shumë emra të njohur, që u inkuadruan në institucionet shtetërore, siç ishte detyra e prefektit dhe e zvendës prefektit edhe në vende tjera të Shqipërisë siç ishin në Berat, Lushnje, Fier, Peqin e vende të tjera. Shembull i veçant për kosovarët përmendim Tafil Boletinin, dhe shumë zyrtarë tjerë që kanë kontribuar në çështjen e sistemit të kosovarëve. Gjithashtu edhe shtypi shqiptar gjatë kohës së Mbretërisë së Shqipërisë për ngjarjet në Kosovë 1929 – 1939, i ka parë me një sy ndryshe, sepse në këtë kohë u bënë edhe shumë marrëveshje, por respektimi i tyre vazhdoi avazin e vjetër, duke mos respektuar të drejtat e shqiptarëve të Kosovës.

Një vëmendje të theksuar kandidati i kushton arsimit gjatë viteve 1929 – 39 dhe kontributin e Internatit “Kosova” për nxënësit kosovarë, është një nga kontributet më të mëdha që dha Prefektura e Kosovës gjatë të gjitha viteve pas suprimimit të qendrës nga Kruma në Kukës. Në këtë mënyrë Internati “Kosova” për kosovarët ishte shëndërruar në një universitet, në të cilin internat përgatiteshin mësues, artistë dhe themelues të institucioneve të më vonshme në Kosovë. Në fund të këtij kapitulli, Zog Çoçaj bën fjalë në pika të shkurtra edhe për çështjen e kufijve, në këtë periudhë kohore 1929 – 39 që u shndërruan në kufi ndarës, ndonëse lëvizja e banorëve nuk u

ndal asnjëherë e më këto lëvizje qarkullonte fshehurazi edhe libri shqip që të depërtonte në çdo cep të Kosovës, përmes nxënësve që i ndiqnin mësimet në Krumë, por edhe me ndihmën e banorëve që jetonin në zonën neutrale ose buze kufirit. Këtu, në këtë pjesë është veçuar kontributin e At Shtjefën Gjeçovit, i cili u vra pikërisht për shkak të aktivitetit të tij të madh atdhetar.

Në përfundim të këtij punimi Zog Çoçaj thekson për të arriturat e këtij studimi dhe ato që nuk janë arritur gjatë përgatitjes së kësaj teme, e që do ta obligojnë që në të ardhmen të vazhdoj hulumtimet rreth kësaj teme sa të gjerë po aq edhe interesante që i ka munguar historiografisë shqiptare.

Vlerësimi dhe Rekomandimi

Nisur nga vlerësimet e sipërthëna Komisioni shkencor për vlerësimin e dorëshkrimit të temës për Doktoraturë të kandidatit Zog Çoçaj , në përbërje të mëposhtme i sugjeron Këshillit Mësimor –Shkencor të Fakultetit Filozofik që ta aprovojë këtë raport dhe të lejoj mbrojtjen publike.

Anëtarët e Komisionit janë:

1. Prof. Dr. Vebi Xhemaili (Kryetar)

2. Prof. Dr. Nebi Dervishi (anëtar)

3. Prof. Dr. Zeqirja Rexhepi (anëtar)

4. Prof. Dr. Isak Sherifi (anëtar)

5. Prof. Dr. Zeqirja Idrizi (Mentor)

